

SHENIMET SPJEGUESE

Subjekti "POTI" SH.P.K

Shenime per Pasqyrat Financiare

Per periudhen 1 Janar 2018 - 31 Dhjetor 2018

1. Te pergjithshme

Subjekti "POTI" sh.p.k . me Nr. NIPT-i L12204038M, eshte rregjistruar ne Organin Tatimor me date 04/10/2011

Veprimtaria e subjektit perfshin : Import-Export material te ndryshme ,kapriata metalike,punime ne fushen e montimit te rafteve metalike..

Aktivitetin e saj, e kryen ne nje objekt te saj Kamez Tirane .



2. Politika kryesore kontabile

Pasqyrat fianciare kane jane pergatitur ne perputhje me nenin nr. 4 te Ligjit nr. 9228, date 29.04.2004 " Per kontabilitetin dhe pasqyrat fianciare i ndryshuar si dhe me Urdherin e Ministrit te Financave Nr. 4292, date 15.06.2006 "Per shpalljen e Standarteve Kontabel Kombetare dhe zbatimin e detyrueshem te tyre". Kjo sepse shoqeria jone ploteson kushtet qe te zbatoje SKK.

Hartimi i tyre eshte bere mbi bazen e te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara dhe parimit te vijimesise duke respektuar karakteristikat e tyre cilesore:

- Kuptushmerine , per te qene informuese per perdoruesit e tyre
- Rendesine , duke paraqitur vetem ate informacion qe ndikon ne vendimet e perdoruesve
- Besueshmerine duke dhene informacionin e plote, te paanshem, te vleresuar me kujdes ku permbajtja ekonomike ka perparesi ndaj formes ligjore.

Persa i perket kupueshmerise jane te krahesueshme jane aplikuar Standartet Kombetare te Kontabilitetit te cilat nuk zbatohen ne retrospektive.

Jane perpiluar 4 pasqyrat kryesore :

1. Bilanci
2. Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve
3. pasqyra e fuksit te parase
4. Pasqyra e ndryshimeve ne kapital

Te kater pasqyrat jane pergatitur per periudhen 01.01.2018– 31.12.2018, jane paraqitur ne leke pa perdorur rrumbullkim shifrash.


Per llogarite qe kane patur transaksione ne valute (euro ose \$) tepricat e tyre jane rivleresuar me date 31.12.2017 me kursin e bankes se Shqiperise ne kete date 1 euro=123.42 leke, dhe 1\$ = 107,82 leke.

Shenimet shpjeguese do te japim informacion te hollesishem dhe te nevojshe mbi pothuajse te gjithe zerat e pasqyrave.

2.1. Bazat e pergatitjes

Deklarimet financiare te bashkengjitura jane pergatitur ne baze te rregjistrimeve kontabel te mbajtura per qellime te kontabilitetit te vendit konform Ligjit Nr.9228 date 29.02.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Pasqyrimi i rezultati per vitin 2018 eshte pasqyruar ne formatin e paraqitur ne Standartet Kombetare te Kontabilitetit ne fuqi (SKK15).



Gjate hartimit te pasqyrave financiare jane ruajtur politikat kontabile.

Sipas parimeve te kontabilitetit, deklarimet financiare jane pergatitur mbi bazen e konceptit te te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara.

Pergatitja e pasqyrave financiare ne perputhje me kerkesat e SKK, kerkon perdorimin e disa vleresimeve kontabile te rendesishme. Kjo gjithashtu kerkon qe menaxhimi i subjektit te jape gjykimin mbi zbatimin e politikave kontabile.

Fushat te cilat kerkojne nje shkalle te larte ose komplekse te gjykimit ose ato per te cilat vleresimet apo supozimet jane te rendesishme per hartimin e pasqyrave financiare paraqiten ne shenime.

Shpenzimet qe lidhen me te ardhurat e fituara gjate periudhes raportuse njihen ne te njejten periudhe kontabel si dhe te ardhurat perkatese.

Shpenzimet e kryera gjate nje periudhe raportuse, qe ndryshon nga periudha kur ato i sjellin perftime njesise ekonomike raportuse, rregjistrohen si shpenzime pikerisht ne periudhen kur merren perftimet.w2

Mbajtja e kontabilitetit i cili perfshin si rregjistrimet kontabile dhe sistemin e tij, mbahen ne menyre te kompjuterizuar, me ane te nje programi te kontabilitetit.

Deklarimet financiare jane te shprehura ne leke, e cila eshte monedha shqiptare.

Nje permbledhje te pjeses me te madhe te politikave kontabel mbi bazen e te cilave jane pergatitur deklarimet financiare jane paraqitur sa meposhte :

2.2. Instrumentat financiare

Shoqeria ka vetem instrumenta financiare jo derivative, perfshire dhe kerkesa nga kliente dhe kerkesa te tjera, mjete likuide e te ngjashme me to, huamarie e huadhenie, furnitore e te tjera detyrime.

Instrumentat financiare jo derivative njihen fillimisht me vleren e drejte plus çdo kosto te drejtperdrejte transaksioni te lidhur me to.



Mjete monetare

Zeri para ne dore dhe te ngjashme perfshin parate ne dore, depozita rrjedhese ne banke.

Kerkesa per tu arketuar

Kerkesa per tu arketuar afatshkurtera jane paraqitur ne bilanc me kosto te amortizuar.

Detyrime te pagushme

Detyrimet per tu paguar dhe te tjera detyrime jane paraqitur me vleren e drejte te tyre.

Te tjera


Te tjera instrumenta financiare jo derivative maten me kosto te amortizushme duke perdorur metoden e interesit efektiv, minus çdo humbje nga zhvleresimi.

2.3. Inventaret

Inventaret jane paraqitur ne pasqyrat financiare te subjektit duke perdorur vleren e blerjes se tyre qe eshte me e vogel se vlera neto e realizueshme. Vleresimi i inventareve perfshin te gjitha shpenzimet e blerjes dhe shpenzimet e tjera qe sherbejne per te sjelle inventaret ne vendin dhe ne gjendje perdorimi (si p.sh shpenzimet e transportit, etj). Vleresimi i inventareve eshte bere me koston. Metoda e perdorur eshte metoda FIFO. Inventaret e mallrave te blera per rishitje, maten fillimisht me koston e blerjes qe perfaqeson çmimin e blerjes, shpenzimet e transportit, taksen doganore.

2.4. Aktivet afatgjate materiale

Ne bilanc Aktivet Afatgjate Materiale paraqiten me koston e blerjes plus amortizimin e akumuluar Aktivet Afatgjate Materiale jane vleresuar me koston e blerjes dhe kosto te tjera te drejtperdrejta qe lidhen me sjelljen e aktivitetit ne kushtete e nevojshme per funksionimin e tij Per llogaritjen e amortizimit eshte perdorur metoda zbritese.



2.5. Njohja e te ardhurave

Te ardhurat jane hyrje bruto te perfitimeve ekonomike gjate periudhes te cilat vijne nga veprimtaria e zakonshme. Te ardhurat perfshijne vetem vleren e drejte te perfitimeve

ekonomike nga shitja e mallrave. Te ardhurat perfshijne shumat neto pa perfshire tatimin mbi vleren e shtuar etj, te cilat nuk jane perftime ekonomike te subjetit. Ne lidhje me shitjen e mallrave te ardhurat jane njohur kur ndryshimi i pronesise se bashku me riskun qe vjen nga ky ndryshim jane transferuar tek bleresi.

2.6. Shpenzimet

Shpenzimet jane njohur mbi bazen e te drejtave te konstatuara.

2.7. Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Inventari

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhurat nga interesi ne llogarine rrjedhese ne banke si dhe fitimet nga kembimet valutore.

Shpenzimet financiare paraqesin shpenzimet per interesa nga huate si dhe humbje nga kembimet valutore.



2.8. Tatimi mbi fitimin aktual

Shpenzimi (e ardhura) tatimore permban shpenzimin tatimor aktual (te ardhuren tatimore aktuale) dhe shpenzimin tatimor te shtyre (te ardhuren tatimore te shtyre). Shpenzimet qe lidhen me tatimin mbi fitimin paraqiten ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

2.9. Transaksionet ne monedha te huaja

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen baze duke perdorur kurset e kembimit ne daten e kryerjes se transaksionit. Fitimet dhe humbjet qe kane rezultuar gjate

konvertimit ne fund te vitit jane pasqyruar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Gjendja e mjeteve monetare ne arke, banke, detyrimet e klienteve e te

POTI sh.p.k

furnitoreve ne monedha te huaja jane rivleresuar me kursin e dates 31.12.2018 (EURO 123.42 Dollari 107.32).

Per rubrikat te cilat nuk jane prekur me kontabilizimet gjate vitit nuk po japim shenime lidhur me instrumentat financiare.

A K T I V E T

A K T I V E T	2017	2017
Aktivet Afatshkurtra		
▶ Aktivet monetare	8,407,219	5,215,291
1 <i>Banka</i>	8,407,219	5,215,291
2 <i>Arka</i>	0	0

Mjetet monetare perfaqesojne depozitat ne banke te cilat jane te pasqyruara sipas bankave analitike si me poshte :

Nr	Banka	Monedha	Gjendja
1	Raifaisen Bank	Lek Shqiptar	878,813
2	INTESA SANPAOLO	Lek Shqiptar	2,641,787
3	Raifaisen Bank	Euro	25097.37
4	INTESA SANPAOLO	Euro	12491.48
	TOTALI		8,407219



Per llogarite ne valute eshte bere azhornimi me kursin e kembimit te dates 31.12.2016, ku 1 euro = 123.42 leke dhe 1\$ = 107.32 leke. Diferencat nga kurset e kembimit jane pasqyruar ne fiteme dhe humbje nga kembimi.

POTI sh.p.k

Kerkesa te tjera te arketueshme.

▶ Të drejta të arkëtueshme	54,073,958	48,615,033
1 <i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>	51,177,758	47,192,997
2 <i>Nga njësitë ekonomike brenda grupit</i>		
3 <i>Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>	0	0
4 <i>Shteti detyrime</i>	2,896,200	1,422,036
5 <i>Kapital i nënshkruar i papaguar</i>		

Klientet jane te rakorduar ne kontabilitetin e shoqerise dhe jane te evidentuar nga ana e shoqerise ne menyre analitike.

Shoqeria ne krahasim me vitin paraardhes ka ritje ne zerin kliente. Ne daten 31/12/2018, 51,177,758 jane paraqit detyrime nga klientet deri me 31/12/2018



Aktivet financiare afat shkurtra perfaqesojne detyrimet e klienteve ne daten 31/12/2018.

▶ Inventarët	15,948,992	11,800,900
1 <i>Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme</i>	15,688,773	11,800,900
2 <i>Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte</i>		
3 <i>Inventar i imet</i>	260,219	
4 <i>Mallra</i>		
5 <i>Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)</i>		
6 <i>AAGJM të mbajtura për shitje</i>		
7 <i>Parapagime për inventar</i>		

Inventari perfaqeson gjendjen e materialeve te konsumueshme me 31.12.2018 sipas inventarit fizik.

Inventari eshte vleresuar me koston e blerjes per faktin se kostoja e blerjes eshte me e ulet se vlere neto e realizushme. Bashkengjitur shenimeve shpjeguse eshte dhe pasqyra analitike e inventarit te mallrave per shitje me date 31/12/2018.

POTI sh.p.k

Gjendje te inventarit paraqiten ne bilanc me date 31.12.2018 eshte 0

Janë zbatuar konform normave dhe rregullave procedura e vlerësimit të stokut sipas SKK4.

Janë kryer rakordimet e inventarit kontabël me kartelat financiare e bilancin kontabel gjate periudhes ushtrimore.

Mbi këtë baze ne krijojme sigurine qe :

Rregjistrimet e stokut jane konform ligjeve

Vleresimi i stokut eshte i drejte dhe eshte bere sipas SKK4 ku inventaret vleresohen me VRN .

Në lidhje me sasine gjendje me date 31.12.2018 ne nuk mund te shprehemi mbasi ne kete date ne nuk kemi marre misionin e auditimit.



II AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Aktivet afatgjata materiale jane pasqyruar ne bilanc me vleften e mbetur pra me vleren kontabile neto mbas zbritjes se amortizimit.

Inventari i aktiveve afatgjate materiale eshte vleresuar me koston e blerjes dhe kosto te tjera te drejtperdrejta. Amortizimi i aktiveve materiale afatgjate eshte llogaritur me % sipas legjislacionit ne fuqi.

Totali i aktiveve afatgjata materiale me date 31.12.2018 eshte 15,912,868 leke si me poshte i analizuar :

▶ Aktivet materiale	15,912,868	2,185,748
----------------------------	-------------------	------------------

POTI sh.p.k

1	<i>Toka</i>	0	0
2	<i>Ndertesa</i>	7,006,609	0
3	<i>Mobilje dhe pajisje zyre</i>	491,729	610,051
4	<i>Mjete transporti</i>	7,438,505	1,049,057
5	<i>Pajisje zyre</i>	373,984	526,640
6	<i>Pajisje informatike</i>	602,041	


Per vitin 2018 shoqeria ka blere 14,983,879 leke aktive aftgjata materiale dhe keto jane kryesisht paisje zyre dhe informative.

Llogaritja e amortizimit per aktivet eshte eshte bere konforme ligjeve . Aktivet afatgjata materiale jane te evidentuara ne kontabilitet ne llogarite perkatese dhe te vleresuara me vleren kontabile neto sipas SKK5 .

I PASIVET AFATSHKURTERA

Shoqeria ka detyrime per tu paguar pas dates 31.12.2018 pasive afatshkurtera zeri huate dhe parapagimet jane si me poshte:

►	Detyrime afatshkurtra:	50,688,89	26,712,79
		1	2
1	<i>Titujt e huamarrjes</i>		
2	<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>		
3	<i>Arkëtime në avancë për porosi</i>	0	0
4	<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>	47,140,92	20,152,49
		7	8
5	<i>D</i>		
6	<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit</i>		
7	<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>	0	4,285,723
8	<i>Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>	3,095,358	2,057,302
9	<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore</i>	452,606	217,269



POTI sh.p.k

Ne llogaritjen e detyrimeve shoqeria ka mbajtur parasysh kerkesat e Ligjit Nr.9920, date 19. 05. 2008, "Per Proçedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise, I ndryshuar Ligji Nr.7928, date

27. 04. 1995, "Per TVSH",I ndryshuar Ligjit Nr.8483, date 28. 12. 1998, "Per Tatimin mbi te Ardhurat", duke i pasqyruar e rregjistruar, tvsh, sigurimet shoqerore e shendetesore si dhe tatimin mbi te ardhurat per vitin 2017, drejt dhe te pagabuara.

Formulari i deklarimit dhe pageses se TVSh per muajin Dhjetor kuadron me kontabilitetin dhe rregjistrat tatimore.

Gjate vitit 2018 jane llogaritur deklaruar dhe jane shlyer detyrimet per sigurimet shoqerore e shendetesore te cilat jane kalkuluar, rregjistruar saktesisht dhe ne pershtatje me ndryshimet ne legjislacionin perkates.

Detyrimet tatimore perbehen si me poshte :

1.Tatim mbi fitimin	279,338
2. Sigurime shoqerore e shendetesore	173,268



II. PASIVET AFATGJATA

	► Detyrime afatgjata:	11,970,137	17,948,623
1	<i>Titujt e huamarrjes</i>	0	0
2	<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>		
3	<i>Arkëtimet në avancë për porosi</i>	1,165,015	
4	<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>	10,805,122	17,948,623
5	<i>Dëftesa të pagueshme</i>		
6	<i>Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit</i>		

POTI sh.p.k

	7 <i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>		
	8 <i>Të tjera të pagueshme</i>		

Ne pasivet aftagjata ne te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit shoqeria ka paraqitur paradheniet e leshuara nepermjet faturave tatimore te cilat jane deklaruar per efekt pagese tvsh. Ne shumen 1,165,015 lek jane fatura paradhenie te leshuara nga shoqeria per efekt tvsh.

III. KAPITALI

Kapitalet e veta me vlere 50,688,891 leke jane detajuar sipas zerave si me poshte :

Per vitin 2018 shoqeria ka dale me nje rezultat ne shumen 8,528,452 leke

	DETYRIMET TOTALE	50,688,891	26,712,792
▶	Kapitali dhe Rezervat	0	0
▶	Kapitali i Nënshkruar	100,000	100,000
▶	Primi i lidhur me kapitalin		
▶	Rezerva rivlerësimi		
▶	Rezerva të tjera		
	1 <i>Rezerva ligjore</i>		
	2 <i>Rezerva statutore</i>	1,152,712	751,668
	3 <i>Rezerva të tjera</i>	21,902,845	14,282,993
▶	Fitimi i pashpërndarë		
▶	Fitim / Humbja e Vitit	8,528,452	8,020,896

TE ARDHURAT

Subjekti per vitin 2018 ka realizuar te ardhura nga shitja neto e mallrave ne shumen :



POTI sh.p.k

Qarkullimi total i cili eshte raportuar fiskut gjate vitit 2017 sipas formularit te deklarimit dhe pageses se TVSH-se por te ardhurat jane te perbera nga te ardhura nga shitjet e prodhimit te tij.

Nr	Pershkrimi i Elementeve	2018	2017
▶	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	74,584,067	53,165,226
▶	Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces		
▶	Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar		
▶	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit		

Ne te ardhurat nuk perfshihet shuma prej 1,165,065 te cilat jane te pasqyruar ne pasiv te pasqyrave financiare.

SHPENZIMET

▶	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	57,081,510	39,365,219
	1 Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	39,193,722	30,938,489
	2 Të tjera shpenzime	17,887,788	8,426,730
▶	Shpenzime të personelit	5,650,608	4,363,659
	1 Paga dhe shpërblime	4,841,995	3,739,211
	2 Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)	808,613	624,448
		0	0
▶	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	1,256,758	522,372
▶	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	0	0
▶	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	0	0



Shpenzimet per vitin ushtrimor jane shpenzime te detajuara dhe i sherbejne kryesisht aktivitetit.

▶	Shpenzime financiare	561,718	0
	1 Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet NGA KURSI KEMBIMIT)	561,718	0

POTI sh.p.k

	2 Shpenzime të tjera financiare		
--	---------------------------------	--	--

FITIMI I VITIT USHTRIMOR

Fitimi neto llogaritur si me poshte;

▶	Fitimi/Humbja para tatimit	10,033,473	9,436,348
▶	Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	1,505,021	1,415,452
	1 Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	1,505,021	1,415,452
	2 Shpenzimi i tatim fitimit të shtyrë		
	3 Pjesa e tatim fitimit të pjesëmarrjeve		
▶	Fitimi/Humbja e vitit	8,528,452	8,020,896

Fitimi para tatimit eshte 10,033,473 leke. Shpenzimet e tatim fitimit 1,505,021 leke .Per plotesim e pasqyres se fluksit monetar eshte perdorur metoda indirekte duke pasqyruar zerat qe kane ndikuar ne ritje ose ne paksim te mjeteve monetare.

Ngjarje te ndodhura pas mbylljes se Pasqyrave Financiare qe duhet te regjistrohen nuk ka.

ADMINISTRATORI

Astrit Poti



Hartuesja e Pasqyrave Financiare

Nezina Cenga

